



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 02, Datë 11.01.2021

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBPETROL” SH.A. PËR SHTYRJE TË AFATIT TË  
VENDIMARRJES FINALE TË BORDIT TË ERE-s.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 16, pika 12; neneve 46 dhe 56 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar; nenit 67, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.01.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 143/1 prot, datë 29.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., për shtyrje të afatit të vendimarrjes përfundimtare të bordit të ERE-s,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin Nr. 13, datë 23.01.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë).
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE me shkresën nr. 62/2 Prot, datë 24.01.2020, ka kryer njoftimin në median e shkruar dhe me shkresën nr. 291 prot, datë 28.01.2020, ka përcjellë pranë shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., njoftimin për vendimin e fillimit të procedurës dhe për zhvillimin e një seance dëgjimore për të sqaruar në lidhje me dokumentacionin e munguar, atë të plotësuar pjesërisht në aplikim apo nevojën për informacion shtesë.
- Në seancën e caktuar në datën 07.02.2020, nuk u paraqitën përfaqësuesit e “ALBPETROL” sh.a., dhe në vijim ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 291/1 Prot, datë 12.02.2020, duke i rikujtuar kërkesën për plotësim dokumentacioni apo dhënien e informacionit shtesë në lidhje me aplikimin e “ALBPETROL” sh.a..
- Në përgjigje të ERE-s, shoqëria “ALBPETROL” sh.a. me shkresën protokolluar në ERE nr. 291/2 Prot, datë 02.03.2020, paraqiti kërkesën për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit të munguar në aplikimin për licencim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë), për shkak se shoqëria ishte në proces riskstrukturimi dhe nga ky ristrukturim ishin prekur punonjës të cilët e kishin për detyrë të merreshin me

plotësimin e këtij dokumentacioni. Shoqëria “Albpetrol” sh.a., theksoi se e ka të domosdoshme pajisjen me këtë licencë, duke qenë se në objektin e veprimtarisë së saj ka kryerjen e operacioneve hidrokarbure.

- Me shpalljen e gjendjes së epidemisë për shkak të Covid 19, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.03.2020, u vendos shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 dhe në rrethanat e masave të jashtëzakonshme të marra nga Qeveria Shqipëtare, si dhe rrethanave të deklaruara nga aplikuesi, plotësimi i dokumentacionit të munguar rezultoi i vështirë.
- Bordi i ERE-s me vendimin Nr. 65, datë 08.04.2020, vendosi të zgjasë me 90 ditë kalendarike afatin e përfundimit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për licencim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror të shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
- Shoqëria “Albpetrol” sh.a. me shkresën nr. 3799 prot, datë 06.07.2020, protokolluar në ERE me nr. 291/6, datë 06.07.2020, ka paraqitur serish një kërkesë për shtyrjen e vendimarrjes së bordit mbi këtë licencim me 3 deri në 6 muaj, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Në vijim të kërkesës së shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., ERE me vendimin Nr. 120, datë 17.07.2020, Bordi i ERE-s vendosi të pranojë kërkesën e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për zgjatjen e afatit të procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror, deri në datën 06.01.2021.
- ERE njoftoi këtë vendimarrje dhe me shkresën nr. 1034 prot, datë 10.08.2020, ka rinjoftuar shoqërinë për detyrimin e paraqitjes brenda afateve në ERE të dokumentacionit të munguar në këtë aplikim.
- Shoqëria “ALBPETROL” sh.a., me shkresën protokolluar në ERE me nr. 291/7 prot, datë 24.12.2020, ka përcjellë një pjesë të dokumentacionit të munguar, por me shkresën nr. 7362 prot, datë 24.12.2020, protokolluar në ERE me nr. 291/8, datë 24.12.2020, ka kërkuar shtyrjen e afatit të depozitimit të dokumentacionit, në lidhje me aplikimin për licencën e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakice)” me 3 (tri) muaj duke filluar nga data 31.12.2020.
- Shoqëria ka kërkuar shtyrjen e afatit duke filluar nga data 31.12.2020, pasi ky ka qenë afati i përcaktuar në vendimin nr. 120/2020, brenda të cilit duhej të depozitonte dokumentacionin e munguar e më pas deri në datën 06.01.2021, është konsideruar koha e ERE-s për të përgatitur praktikën për trajtim në Bord. Si e tillë afatet e shtyrjes do të fillojnë nga data 06.01.2021, për tre muaj sipas kërkesës së shoqërisë ALBPETROL sh.a..
- Kjo kërkesë vjen për arsye se, shoqëria ALBPETROL sh.a., është duke kaluar një situatë të vështirë financiare të ardhur si rezultat i dështimit të shitjes së produktit “nafte brut” e cila është pasojë e situatës së krijuar nga COVID 19. Shoqëria aktualisht nuk ka një gjendje të mirë financiare, pavarësisht mundësisë reale për të krijuar të ardhura. Ajo ka raporte të palikuiduar me të tretët dhe me Shtetin Shqiptar.

- Në lidhje me shtyrjen e afateve procedurale nga organi publik, Ligji nr. 44.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 67, pika 1 citon se: 1. *“Organi publik, që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar, mund të marrë edhe vendime të ndërmjetme, kur gjykohet se mosmarrja e masave të caktuara do të shkaktonte një dëm të rëndë e të pariparueshëm mbi interesin publik, apo të drejtave ose interesave të ligjshëm të palëve”.*

Në konsideratë të sa më sipër, duke qenë se kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës është depozituar në zbatim të legjislacionit në fuqi, përpara përfundimit të afatit të vendosur në Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 120, datë 17.07.2020, dhe duke marrë parasysh të gjitha kufizimet e vendosura gjatë kësaj periudhe me qëllim parandalimin e përhapjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, dhe arsytet të tjera të paraqitura më sipër, vlerësojmë se kërkesa e shoqërisë duhet të pranohet.

- Në lidhje me dokumentacionin e munguar, do të njoftohet subjekti që t’i paraqesë ato në ERE, brenda afateve që do të percaktojë vendimi i Bordit për shtyrjen e vendimmarrjes finale mbi këtë aplikim.

Vendosi:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., për zgjatjen e afatit të procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror, për 3 (tre) muaj, duke filluar nga data 06.01.2021 e deri në datën 06.04.2021.
2. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. të marrë masa për të depozituar në ERE dokumentacionin e munguar jo më vonë se data 30.03.2021.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**

